Jet.bank

Banka Jet SH.A.

RAPORTIM PERIODIK

TREMUJORI III | SHTATOR 2026

www.jet.bank

1.
INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI BANKËN

a) Të përgjithshme

Banka Jet Sh.a. (“Jet Bank”) është banka e parë 100% digjitale në Shqipëri, e licencuar dhe e mbikëqyrur nga Banka e Shqipërisë. Shoqëria u themelua më 23 korrik 2025 si shoqëri aksionare me seli në Tiranë dhe është në pronësi të plotë të Jet Holdings B.V., Holandë. Banka u krijua me objektiv ndërtimin e një modeli bankar modern, të bazuar tërësisht në kanale digjitale, duke ofruar produkte dhe shërbime bankare për individë dhe biznese përmes platformave teknologjike.
Gjatë periudhës së themelimit dhe përgatitjes për fillimin e aktivitetit bankar, Banka ndërmori procesin e ngritjes së infrastrukturës teknologjike, organizative dhe operacionale, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore të Bankës së Shqipërisë. Më 25 mars 2026, Banka mori licencën për ushtrimin e aktivitetit bankar nga Banka e Shqipërisë, duke u bërë banka e parë plotësisht digjitale në vend. Pas përfundimit të fazës së implementimit dhe testimit të sistemeve, Banka filloi operacionet e saj të plota në qershor 2026.

Në datën 30 qershor 2026, kapitali i regjistruar dhe i paguar i Bankës arrinte në 1.914 miliardë lekë, i ndarë në 3,500 aksione të zakonshme, të gjitha në pronësi të Jet Holdings B.V.. Niveli i kapitalizimit pasqyron angazhimin afatgjatë të aksionarit për të mbështetur zhvillimin e Bankës dhe për të siguruar një bazë të fortë financiare për zgjerimin e aktivitetit të saj.
Që nga themelimi, kapitali i Bankës është rritur në mënyrë progresive përmes kontributeve në mjete monetare të aksionarit të vetëm. Fillimisht, kapitali i regjistruar ishte 3.5 milionë lekë, ndërsa më 9 mars 2026 u rrit në 1.059 miliardë lekë. Më pas, janë realizuar disa rritje të tjera kapitali: më 22 prill 2026, duke arritur në 1.196 miliardë lekë, më 24 prill 2026, duke u rritur në 1.578 miliardë lekë, më 11 qershor 2026, kapitali arriti në 1.914 miliardë lekë dh e rritja e fundit është kryer më 25 gusht 2026, duke e çuar kapitalin e bankës në shumën prej 2.465 miliardë lek. Këto injektime kapitali kanë financuar procesin e themelimit dhe zhvillimit të Bankës, përmbushjen e kërkesave rregullatore të kapitalit të Bankës së Shqipërisë, si dhe krijimin e kapaciteteve të nevojshme operacionale dhe teknologjike për fillimin dhe zgjerimin e aktivitetit bankar.

b) Aksionerët me pjesëmarrje influencuese:

Jet Holdings B.V., me seli në Prinses Margrietplantsoen 33, 2595AM ‘s-Gravenhage, Holandë, zotëron 100% të kapitalit aksionar të Bankës dhe 100% të të drejtave të votës.

KAPITALI

TREGUES	VLERA
Shuma e kapitalit të regjistruar (mijë Lekë)	**2,465,386**
Shuma e kapitalit të paguar (mijë Lekë)	**2,465,386**

2.
STRUKTURA E ORGANIZIMIT, ADMINISTRIMIT DHE DREJTIMIT

a) Struktura organizative

Struktura organizative e Jet Bank është ndërtuar për të siguruar qeverisje efektive, ndarje të qartë të përgjegjësive dhe funksione të pavarura kontrolli.
Në krye qëndron Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve, e ndjekur nga Bordit Drejtues, i mbështetur nga Komiteti i Riskut dhe Komiteti i Auditimit.
Menaxhimi ekzekutiv drejtohet nga CEO, i cili mbikëqyr drejtuesit e funksioneve kryesore të bankës (Operacionet dhe Teknologjia, Risku, Financa, Retail Banking dhe Marketingu), si dhe funksionet mbështetëse, duke përfshirë Burimet Njerëzore, Logjistikën dhe Prokurimet, Trading dhe Asistentin Ekzekutiv.
Auditimi i Brendshëm vepron në mënyrë të pavarur nën mbikëqyrjen e Komitetit të Auditimit.

b) Struktura e Bordit Drejtues dhe Drejtorisë Ekzekutive

BORDI DREJTUES	POZICIONI
Esther Deutsch	**Kryetar**
Philippe Edgar Meyer	**Anëtar**
Fatbardha Rino	**Anëtar**
Alketa Emini	**Anëtar**
Robert Ryan Rudolph	**Anëtar**

DREJTORIA EKZEKUTIVE	POZICIONI
Fatbardha Rino	**Drejtore Ekzekutive**
Alketa Emini	**Drejtore e Riskut**
Belma Lushi	**Drejtore e Retail**
Ardian Hasa	**Drejtor i Teknologjisë dhe Operacioneve**
Melsen Caca	**Drejtor i Financës**
Besiana Siliqi	**Drejtore Marketing**

c) Struktura e pronësisë

Aksioneri i vetëm i Bankës është Jet Holdings B.V., ndërsa asnjë prej pronarëve përfitues fundorë nuk është pjesë e organeve apo strukturave drejtuese të Bankës.

d) Kualifikimet dhe përvoja e anëtarëve të Bordit Drejtues dhe drejtuesve ekzekutivë

Bordi Drejtues

ESTHER DEUTSCH

ka eksperiencë të gjerë në sektorin bankar, ligjor dhe rregullator, me role drejtuese në Israel Discount Bank dhe pozicione të shumta në borde të institucioneve financiare. Ajo ka shërbyer si Kryetare Bordi në Mercantile Discount Bank dhe CAL – Israel Credit Cards Ltd., si dhe aktualisht është anëtare bordi në Bank Leumi Israel, me fokus në qeverisje, mbikëqyrje rregullatore, risk dhe compliance.

PHILIPPE MEYER

është avokat zviceran me eksperiencë të gjatë në këshillim ligjor korporativ dhe tregtar, me fokus në sektorin financiar, strukturime ndërkombëtare, transaksione dhe qeverisje korporative. Ai ka mbajtur role të shumta në borde dhe mandate përfaqësimi në shoqëri zvicerane, si dhe shërben si anëtar bordi në një institucion të rregulluar të shërbimeve financiare.

FATBARDHA RINO

ka eksperiencë të gjatë në sektorin bankar dhe financiar, me fokus në drejtimin ekzekutiv, transformimin digjital, bankingun retail, kanalet e shitjes, pagesat dhe menaxhimin operacional. Ajo ka mbajtur pozicione drejtuese në Raiffeisen Bank Albania, Raiffeisen Bank International, Banka Union dhe IutePay Albania, dhe aktualisht shërben si CEO/Administratore e Banka Jet Sh.A.

ALKETA EMINI

ka eksperiencë të gjatë në sektorin bankar dhe financiar, me fokus në menaxhimin e riskut, riskun e kreditit, investimet, pajtueshmërinë rregullatore dhe qeverisjen. Ajo ka mbajtur pozicione drejtuese në Raiffeisen Bank Albania dhe Raiffeisen Invest Albania, si dhe ka shërbyer si anëtare e bordeve mbikëqyrëse në institucione financiare.

ROBERT RYAN RUDOLPH

është avokat zviceran me eksperiencë të gjerë në këshillim ligjor korporativ, struktura ndërkufitare, qeverisje dhe mbikëqyrje në nivel bordi. Ai ka shërbyer si anëtar jo-ekzekutiv bordi në institucione të listuara dhe të rregulluara, me fokus në qeverisje, compliance, AML dhe menaxhim risku.

Drejtues Ekzekutiv

FATBARDHA RINO – DREJTORE EKZEKUTIVE

Fatbardha Rino ka eksperiencë të gjatë në sektorin bankar dhe financiar, me fokus në drejtimin ekzekutiv, transformimin digjital, bankingun retail, kanalet e shitjes, pagesat dhe menaxhimin operacional. Ajo ka mbajtur pozicione drejtuese në Raiffeisen Bank Albania, Raiffeisen Bank International, Banka Union dhe IutePay Albania, dhe aktualisht shërben si CEO/Administratore e Banka Jet Sh.A.

ALKETA EMINI – DREJTORE E RISKUT

Alketa Emini ka eksperiencë të gjatë në sektorin bankar dhe financiar, me fokus në menaxhimin e riskut, riskun e kreditit, investimet, pajtueshmërinë rregullatore dhe qeverisjen. Ajo ka mbajtur pozicione drejtuese në Raiffeisen Bank Albania dhe Raiffeisen Invest Albania, si dhe ka shërbyer si anëtare e bordeve mbikëqyrëse në institucione financiare.

MELSEN CACA – DREJTOR I FINANCËS

Melsen Caca ka eksperiencë në sektorin bankar, financiar dhe korporativ, me fokus në financë, raportim financiar, kontroll të brendshëm, planifikim strategjik, menaxhim performance dhe pajtueshmëri rregullatore. Ai ka mbajtur pozicione drejtuese në ProCredit Bank Albania dhe Neptun Albania, si dhe ka eksperiencë në administrim projektesh dhe mbikëqyrje financiare.

BELMA LUSHI – DREJTORE E RETAIL

Belma Lushi ka eksperiencë të gjatë në sektorin bankar, me fokus në bankingun retail, kanalet digjitale, shërbimin ndaj klientit dhe zhvillimin e produkteve retail. Ajo ka mbajtur pozicione drejtuese në ProCredit Bank Albania, përfshirë Head of Retail Division dhe Head of Electronic Banking and Alternative Channels, dhe aktualisht drejton funksionin Retail pranë Banka Jet Sh.A.

ARDIAN HASA – DREJTOR I TEKNOLOGJISË DHE OPERACIONEVE

Ardian Hasa ka eksperiencë të gjatë në sektorin bankar dhe teknologjik, me fokus në operacione bankare, IT, pagesa, kanale digjitale, siguri sistemesh dhe transformim digjital. Ai ka mbajtur pozicione drejtuese në NLB Banka, OTP Bank Albania dhe Societe Generale Albania, dhe aktualisht shërben si COO/CTO pranë Banka Jet Sh.A.

BESIANA SILIQI – DREJTORE E MARKETING

Besiana Siliqi ka më shumë se një dekadë përvojë në marketing, komunikim dhe rritje dixhitale në tregjet rajonale. Ajo ka ndërtuar një karrierë në drejtimin e programeve të mëdha të blerjeve, strategjive të reputacionit dhe zhvillimit të markave për shërbime financiare të bazuara në teknologji. Ajo ka një ekspertizë të njohur në ndërtimin e besimit, përshpejtimin e rritjes së përdoruesve dhe pozicionimin e produkteve të reja financiare në tregjet konkurruese.

e) Kodi i etikës dhe politika e qeverisjes

Jet Bank ka miratuar dhe zbaton Kodin e Etikës, i cili përcakton standardet e sjelljes profesionale, integritetit, përgjegjshmërisë dhe transparencës që zbatohen nga aksionarët, organet drejtuese, drejtuesit dhe punonjësit e Bankës. Kodi promovon respektimin e legjislacionit në fuqi, mbrojtjen e interesave të klientëve, konfidencialitetin e informacionit, parandalimin e mashtrimit dhe korrupsionit, si dhe kulturën e raportimit të shkeljeve etike.

f) Politika për konfliktet e interesit dhe transaksionet me palët e lidhura

Gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj, Banka mund të përballet me situata ku interesat e saj, të klientëve, të punonjësve ose të palëve të tjera të lidhura mund të bien në kundërshtim me njëra-tjetrën. Këto situata përbëjnë konflikt interesi dhe, nëse nuk identifikohen dhe menaxhohen në mënyrë të duhur, mund të ndikojnë negativisht në objektivitetin e vendimmarrjes, integritetin e veprimtarisë së Bankës dhe besimin e klientëve.

Qëllimi i kësaj politike është të sigurojë identifikimin, parandalimin, raportimin dhe menaxhimin efektiv të konflikteve të interesit, në përputhje me legjislacionin bankar dhe standardet më të mira të qeverisjes. Politika synon të mbrojë interesat e Bankës, klientëve dhe punonjësve, duke garantuar që çdo vendimmarrje të bazohet në parimet e integritetit, transparencës, paanshmërisë dhe profesionalizmit.

Në kuadër të kësaj politike, Banka promovon një kulturë integriteti dhe përgjegjshmërie, duke siguruar trajnime periodike, mekanizma të sigurt sinjalizimi dhe rishikim të vazhdueshëm të politikës, me qëllim forcimin e kontrollit të brendshëm dhe mbrojtjen e reputacionit të institucionit.

g) Organigrama e Bankës

Jet Bank është e organizuar në 5 njësi kryesore biznesi, të drejtuara nga anëtarët e menaxhimit ekzekutiv, si dhe në 4 funksione mbështetëse që sigurojnë mbështetjen operacionale dhe administrative të bankës.
Aktualisht, Jet Bank ka një staf prej 55 punonjësish, të angazhuar në funksionet e biznesit, kontrollit dhe mbështetjes.



3.

PERFORMANCA FINANCIARE DHE BILANCI

a) Performanca financiare – Tremujori III 2026

Tremujori i tretë i vitit 2026 ishte periudha e dytë e plotë e aktivitetit operacional të Bankës Jet SH.A. Gjatë kësaj periudhe, Banka u fokusua në vënien në funksion të modelit të saj digjital, ndërtimin e bazës së klientëve dhe krijimin e themeleve për rritjen e aktivitetit në periudhat në vijim. Gjithashtu, në Gusht të vitit 2026, Banka filloi aktivitetin e kreditimit konsumator, duke shënuar një hap të rëndësishëm në zgjerimin e veprimtarisë së saj dhe në ofrimin e produkteve të reja financiare për klientët

Në fund të Shtator 2026, totali i aktiveve të Bankës arriti në 3,2 miliardë lekë. Struktura e bilancit reflekton kryesisht rritjet e kapitalit të realizuara nga aksionari i vetëm, Jet Holdings B.V., fillimin e krijimit të bazës së depozitave nga klientët, kreditimin konsumator si dhe nisjen e aktivitetit të investimit në bono qeveritare dhe të vendosjeve pranë bankave jorezidente. Gjatë periudhës Korrik–Shtator 2026, kapitali aksionar u rrit nga 1.91 miliardë lekë në 2.5 miliardë, duke i siguruar Bankës mbështetjen financiare të nevojshme për fazën e parë të aktivitetit.

Depozitat e klientëve arritën në 1.5 miliardë lekë në fund të tremujorit, ku rreth 39% e totalit përbëhej nga depozitat në llogaritë rrjedhëse dhe 61% nga depozitat me afat. Gjatë tremujorit të tretë, u evidentua një rritje e volumit të depozitave me afat, e cila pasqyron zhvillimin gradual të bazës së financimit dhe rritjen e peshës së burimeve me maturitet të përcaktuar. Ky zhvillim mund të konsiderohet gjithashtu një tregues pozitiv i besimit të klientëve ndaj Bankës JET dhe i konsolidimit gradual të marrëdhënieve të saj me klientelën.

Gjatë këtij tremujori, filloi aktiviteti kreditues. Në fund të tremujorit të tretë, portofoli I kredive arriti në vlerën 200 milionë lekë.
Të ardhurat operative për periudhën arritën në 31,9 milionë lekë. Pjesa më e madhe e tyre u gjenerua nga veprimet në valutë (14.13 milionë lekë) si edhe të ardhurat nga interesi (10.47 milionë Lekë), ndërsa të ardhurat nga komisionet janë në vlerën 4.58 milionë lekë.

Shpenzimet operative lidhen kryesisht me investimet e nevojshme për ngritjen dhe funksionimin e bankës digjitale. Shpenzimet për teknologjinë e informacionit arritën në 591.6 milionë lekë (59% e totalit të shpenzimeve operative), shpenzimet e personelit në 174.3 milionë lekë (17%), ndërsa shpenzimet e marketingut në 148.5 milionë lekë (15%), pjesa tjeter lidhet me shpenzime të tjera operative. Kjo strukturë pasqyron investimet e Bankës në teknologji, burime njerëzore dhe zhvillimin e markës në treg.

Në fund të Shtator 2026, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit ishte 113.5%, dukshëm mbi minimumin rregullator prej 12%. Ky nivel reflekton kapitalizimin e lartë të Bankës. Krahasuar me tremujorin e e mëparshëm vemë re se RMK ka rënë ndjeshëm, rrjedhojë kjo e fillimit të aktivitetit kreditues, duke i dhënë Bankës një bazë të fortë për të mbështetur rritjen e ardhshme.
Pozicioni i likuiditetit gjithashtu mbeti shumë i fortë. Me mbi 2.2 miliardë lekë aktive likuide në fund të tremujorit, Banka kishte kapacitet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet e saj dhe për të financuar zgjerimin e aktivitetit në periudhat në vijim.

Në tërësi, tremujori i tretë i vitit 2026 ishte një periudhë e rëndësishme për zhvillimin e aktivitetit të Bankës, e shoqëruar me rritjen e numrit të klientëve dhe depozitave, fillimin e aktivitetit kreditues dhe zgjerimin e shërbimeve bankare.

Niveli i lartë i kapitalit dhe likuiditetit, së bashku me investimet e realizuara në teknologji, staf dhe marketing, i krijojnë Bankës një bazë të qëndrueshme për rritjen e mëtejshme. Në periudhat në vijim, Banka do të fokusohet në zgjerimin e bazës së klientëve, rritjen e aktivitetit kreditues dhe të ardhurave, si dhe zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve të reja, në përputhje me planin e saj të biznesit.

PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE (NË MIJË LEKË)

	QERSHOR 2026
SHPENZIME TË VEPRIMTARISË BANKARE	**39,335**
Shpenzime për interesa	**6,074**
Humbje nga veprimet me letrat me vlerë dhe veprimet financiare	**7**
Komisione	**32,749**
Shpenzime për operacionet e qirasë	**-**
Shpenzime të tjera të veprimtarisë bankare	**505**
Humbje nga veprimet me valutat	**-**
Shpenzime për personelin	**174,293**
Taksa të tjera përveç taksave mbi të ardhurat	**4**
Shpenzime të përgjithshme të veprimtarisë	**833,034**
Amortizimi dhe fondet rezervë për zhvlerësimin e mjeteve të qëndrueshme	**2,065**
Humbje nga llogaritë për t'u arkëtuar të pambledhshme shpenzime për fonde rezervë	**1,997**
Shpenzime të jashtëzakonshme	**420**
Taksa mbi të ardhurat	**-**
Fitimi i vitit në vazhdim	**-**
TOTALI I SHPENZIMEVE	**1,051,148**
Të ardhura të veprimtarisë bankare	**31,920**
Të ardhura nga interesat	**10,472**
Të ardhura nga veprimet me letrat me vlerë dhe veprimtaritë e tjera financiare	**2,178**
Komisione për shërbime bankare	**4,580**
Të ardhura nga veprimet e qirasë	**-**
Të ardhura të tjera të veprimtarisë bankare	**555**
Fitime nga veprimet me valutat	**14,135**
Transferime nga fondet rezervë për zhvlerësimin e mjeteve të qëndrueshme	**-**
Transferime nga fondet rezervë për zhvlerësimin e llogarive për t'u arkëtuar	**-**
Të ardhura të jashtëzakonshme	**-**
Humbja e vitit në vazhdim	**1,019,228**
TOTALI I TË ARDHURAVE	**1,051,148**

BILANCI | AKTIVET (NË MIJË LEKË)

ZËRI	SHTATOR 2026
Arka dhe Banka Qendrore	**1,459,596**
Bono thesari dhe bono të tjera të pranueshme për rifinancim me Bankën Qendrore	--
Llogari rrjedhëse në bankat, instituc. e kreditit dhe instituc. e tjera financiare	**255,803**
Depozita me bankat, institucionet e kreditit dhe institucione të tjera financiare	**239,330**
Hua për bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare	--
Llogari të tjera me bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare	--
Llogari për t'u arkëtuar të dyshimta në bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare	--
VEPRIMET ME KLIENTËT (BRUTO)	**199,652**
Hua standarde dhe paradhënie për klientët	**199,652**
Hua dhe paradhënie në ndjekje	--
Hua nënstandard	--
Hua të dyshimta	--
Hua të humbura	--
Qeveria Shqiptare & Administrata Publike	--
Detyrimet ndaj klientëve për llogaritë rrjedhëse dhe depozitat	--
VEPRIME ME LETRAT ME VLERË	**399,126**
Letra me vlerë me të ardhura fikse	**399,126**
Letra me vlerë me të ardhura të ndryshueshme	--
Letra me vlerë të blera dhe të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes	--
Garancia e ofruar për transaksionet me letrat me vlerë	--
MJETE DHE DETYRIME TË TJERA	**567,164**
Mjete të tjera	**309,942**
Transaksionet si agjent	--
Llogari pezull dhe të pozicionit	**257,222**
Tatim i vlerës së shtuar	--
MJETET E QËNDRUESHME DHE BURIMET E PËRHERSHME	**36,361**
Mjete të qëndrueshme	**36,361**
TOTALI I AKTIVEVE	**3,157,032**

PASIVET (NË MIJË LEKË)

ZËRI	SHTATOR 2026
Banka Qendrore	--
Bono thesari dhe bono të tjera të përshtatshme për rifinancim me Bankën Qendrore	--
Llogari rrjedhëse me bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare	--
Depozita nga bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare	--
Hua marrë nga bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare	--
Llogari të tjera me bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare	--
VEPRIME ME KLIENTËT	**1,521,222**
Qeveria shqiptare dhe administrata publike	--
Detyrime ndaj klientëve për llogaritë rrjedhëse dhe depozitat	**1,521,222**
Llogari të tjera të klientëve	--
VEPRIME ME LETRAT ME VLERË	--
Borxh i përfaqësuar nga letrat me vlerë	--
Letra me vlerë të blera dhe të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes	--
Garancia e ofruar për transaksionet me letrat me vlerë	--
Çmimet (primet) për instrumentat financiare	--
MJETE DHE DETYRIME TË TJERA	**391,092**
Detyrime të tjera	**298,131**
Transaksionet si agjente	--
Llogaritë e marrëdhënieve	--
Llogaritë pezull dhe të pozicionit	**87,666**
Tatimi i vlerës së shtuar	**5,294**
MJETE TË QËNDRUESHME DHE BURIME TË PËRHERSHME	**1,244,718**
Ndihma dhe financimi publik	--
Fondet rezervë specifike	**1,997**
Borxhi i varur	--
KAPITALI I AKSIONERËVE	**1,242,722**
Kapitali i paguar	**2,465,386**
Primet e aksioneve	--
Rezerva	--
Diferenca e rivlerësimit	--
Fitimi (humbja) i pashpërndarë	**(203,436)**
Fitimi (humbja) i vitit ushtrimor	**(1,019,228)**
TOTALI	**3,157,032**

TREGUESIT E RENTABILITETIT

TREGUES	VLERË
ROAA = Të ardhurat neto / Aktive mesatare × 100	**-57.66%**
Rezultati neto i jashtëzakonshëm / Aktive mesatare	**-0.02%**
Shpenzime të përgjithshme të veprimtarisë / Të ardhura bruto	**2609.79%**
Të ardhura neto nga interesi / Shpenzime të përgjithshme	**0.53%**
ROAE = Të ardhurat neto / Kapitali aksioner mesatar × 100	**-62.06%**
Aktive për punonjës = Totali i aktiveve / Numri i punonjësve	**46,426,937**
Të ardhura neto nga interesat / Aktive mesatare	**0.25%**
Marzhi neto nga interesat (NII / Aktive mesatare që sjellin të ardhura)	**1.03%**
Të ardhurat nga interesat / Aktive mesatare	**0.59%**
Shpenzime për interesa / Aktive mesatare	**0.34%**
Të ardhura neto nga interesat / Të ardhura bruto të veprimtarisë	**13.78%**
Të ardhura neto nga veprimtaritë e tjera / Aktive mesatare	**-0.67%**
Shpenzime jo për interesa / Të ardhura bruto	**3266.51%**
Shpenzime personeli / Të ardhura bruto	**546.04%**
Shpenzime për provigjone / Aktive mesatare	**0.11%**

b) POLITIKAT KONTABËL

• Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare të përmbledhura janë përgatitur në përputhje me "Metodologjinë e Raportimit Financiar" ("MRF") e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë më 24 dhjetor 2008. MRF u miratua për qëllime rregullatore, në përputhje me Nenin 47 të Ligjit mbi Bankat nr. 9662, datë 18 dhjetor 2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë". Pasqyrat financiare të ndërmjetme të përmbledhura janë përgatitur mbi bazën e kostos historike. Të dhënat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe.
Në përgatitjen e pasqyrave financiare zbatohen parimet e kuptueshmërisë, relevancës, materialitetit, besueshmërisë, maturisë, neutralitetit, plotësisë dhe krahasueshmërisë. Transaksionet paraqiten duke marrë në konsideratë përmbajtjen e tyre ekonomike dhe jo vetëm formën ligjore.

• Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit.
Aktivet dhe detyrimet monetare të shprehura në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Aktivet dhe detyrimet jomonetare të regjistruara me kosto historike nuk konvertohen me kursin e datës së raportimit. Diferencat që rezultojnë nga ndryshimet e kurseve të këmbimit për zërat monetarë njihen në të ardhurat ose shpenzimet e periudhës në të cilën ato lindin.

• Mjete monetare dhe ekuivalentet me to

Për qëllime raportimi të rrjedhës së parasë, aktive monetare dhe ekuivalentet me to përfshijnë gjendjen e arkës dhe aktivet monetare të depozituara në Bankën e Shqipërisë, si dhe investimet afatshkurtra likuide me maturitet origjinal tre muaj ose më pak, me përjashtim të rezervës së detyrueshme.

• Investimet në letrat me vlerë

Investimet në letrat me vlerë përfshijnë Bono Thesari dhe Obligacione Qeveritare. Bono thesari: paraqiten me vlerën e tyre nominale minus interesin e pa maturuar. Obligacionet qeveritare: paraqiten me vlerën e kostos pas zbritjes së provigjoneve për humbje të përhershme.

• Kredi dhënë klientëve

Huatë dhe paradhëniet për klientët njihen në momentin kur Banka bëhet palë në marrëdhënien kontraktore me klientin. Portofoli monitorohet në mënyrë të vazhdueshme për të vlerësuar cilësinë e tij dhe për të identifikuar në kohë çdo tregues të përkeqësimit të aftësisë paguese të huamarrësit. Kreditë paraqiten në bilanc me vlerën e tyre bruto, ndërsa fondet rezervë për humbjet nga kreditë paraqiten veçmas, në përputhje me kërkesat rregullatore të Bankës së Shqipërisë. Interesat mbi kreditë me probleme njihen në përputhje me politikat kontabël të Bankës.

LLOJI I KREDISË	Ditëvonesat	PROVIGJIONI I HUMBJES
Standarde	**0-30 ditë**	**1%**
Në ndjekje	**31-60 ditë**	**5%**
Nënstandarde	**61-90 ditë**	**20%**
Të dyshimta	**91-180 ditë**	**50%**
Të humbura	**Mbi 181 ditë**	**100%**

• Aktive dhe pajisje të trupëzuara

Aktivet afatgjata materiale regjistrohen fillimisht me koston e blerjes ose të ndërtimit, minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluara nga zhvlerësimi.

Kostoja përfshin çmimin e blerjes dhe shpenzimet që i atribuohen drejtpërdrejt sjelljes së aktivit në vendin dhe kushtet e nevojshme për përdorimin e tij.

Shpenzimet pasuese kapitalizohen vetëm kur është e mundshme që përfitimet e ardhshme ekonomike të lidhura me aktivin do të rrjedhin në Bankë dhe kostoja mund të matet në mënyrë të besueshme. Shpenzimet e zakonshme të mirëmbajtjes dhe riparimit njihen në rezultatin financiar në periudhën kur kryhen.
Amortizimi llogaritet sipas metodës lineare gjatë jetës së dobishme të vlerësuar të aktiveve. Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen periodikisht dhe ndryshimet trajtohen si ndryshime në vlerësimet kontabël.

KATEGORIA	JETËGJATËSIA (NË VITE)
Ndërtesa	30
Kompjutera dhe pajisje elektronike	5
Instalime dhe pajisje të ndryshme	5
Mobilje zyre	10
Mjete transporti	5

• Aktive të patrupëzuara

Aktivet afatgjata jomateriale përfshijnë kryesisht programe kompjuterike, licenca dhe të drejta të tjera të përdorimit të sistemeve teknologjike.

Këto aktive njihen fillimisht me koston e blerjes dhe paraqiten më pas me koston e tyre, minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluara nga zhvlerësimi.

Amortizimi llogaritet sipas metodës lineare gjatë jetës së dobishme të vlerësuar të aktivit. Shpenzimet e kryera për mirëmbajtjen e sistemeve dhe programeve njihen si shpenzim në periudhën kur kryhen, përveç rasteve kur plotësohen kushtet për kapitalizim.

KATEGORIA	JETËGJATËSIA (NË VITE)
Programe kompjuterike -- Sistemi Bankar	10
Programe kompjuterike të tjera	5

• Përmirësim/përshtatje e ambienteve të marra me qira

Paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar. Amortizimi llogaritet me metodën lineare për periudhën e zgjatjes së qirasë.

• Njohja e të ardhurave

Të ardhurat dhe shpenzimet për interesa njihen në bazë të parimit të të drejtave të konstatuara, me përjashtim të interesave të fituara nga kreditë me probleme, të cilat njihen në momentin e arkëtimit.

• Tatimi

Banka përcakton tatimin në fund të periudhës ushtrimore në përputhje me legjislacionin shqiptar për tatim-taksat, si 15% e të ardhurave të tatueshme.

4.
STRUKTURA E KAPITALIT RREGULLATOR

Kapitali rregullator i Bankës përcaktohet në përputhje me kërkesat e Bankës së Shqipërisë për mjaftueshmërinë e kapitalit dhe përbëhet nga kapitali i nivelit të parë dhe kapitali i nivelit të dytë, pas aplikimit të filtrave prudencialë dhe zbritjeve rregullatore përkatëse.

Në datën 30 qershor 2026, kapitali i Bankës përbëhej nga aksione të zakonshme, të paguara plotësisht nga aksionari i vetëm i Bankës. Aksionet janë të përhershme dhe nuk përmbajnë detyrim kontraktual për kthimin e kapitalit apo për pagesën e një dividendi të garantuar.

Banka nuk ka emetuar instrumente të kapitalit shtesë të nivelit të parë dhe nuk ka instrumente të kapitalit të nivelit të dytë apo borxh të varur. Për rrjedhojë, kapitali rregullator i Bankës përbëhet nga kapitali bazë i nivelit të parë.

Struktura e kapitalit rregullator për datën 30 qershor 2026

PËRBËRËSI	VLERA NË MIJË LEKË
Kapitali i paguar	**2,465,386**
Fitimet e pashpërndara dhe humbjet e mbartura nga periudhat e mëparshme	**(203.436)**
Fitimi ushtrimor i periudhës raportuese	**(1,019,228)**
Aktive të tjera të patrupëzuara	**(13,833)**
Kapitali bazë i nivelit të parë	**1,228,889**
Kapitali shtesë i nivelit të parë	**--**
Totali i kapitalit të nivelit të parë	**1,228,889**
Kapitali i nivelit të dytë	**--**
Borxhi i varur	**--**
Totali i kapitalit rregullator	**1,228,889**

5.
MJAFTUESHMËRIA E KAPITALIT

a) Përshkrim i metodës standarde për vlerësimin e mjaftueshmërisë së kapitalit

Banka vlerëson mjaftueshmërinë e kapitalit në përputhje me kuadrin rregullator të Bankës së Shqipërisë, duke krahasuar kapitalin rregullator të pranueshëm me totalin e aktiveve dhe ekspozimeve të ponderuara me rrezik.

Për llogaritjen e kërkesës për kapital për rrezikun e kredisë dhe rrezikun e kredisë së kundërpartisë, Banka përdor metodën standarde. Sipas kësaj metode, ekspozimet klasifikohen në klasat përkatëse rregullatore dhe ponderohen me koeficientët e rrezikut.

Për rrezikun operacional, Banka përdor metodën Standarde, në përputhje me kërkesat rregullatore të Bankës së Shqipërisë.

TREGUESI	VLERA NË MIJË LEKË
Totali i ekspozimeve të ponderuara për rrezikun e kredisë dhe kundërpartisë	**842,912**
Shuma e ekspozimeve të ponderuara me rrezik për rreziqet e tregut	**239.442**
Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezik për rrezikun operacional	**--**
Totali i aktiveve dhe ekspozimeve të ponderuara me rrezik	**1,082,355**
RAPORTI I KAPITALIT	**PËRQINDJA**
Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit	**113.54%**

6
ADMINISTRIMI I RREZIKUT

a) Strategjitë/proceset e administrimit të rrezikut

Jet Bank ka ngritur një kuadër të integruar për administrimin e rrezikut, të përshtatur me natyrën, përmasat, kompleksitetin dhe profilin e aktivitetit të saj. Kuadri synon identifikimin, vlerësimin, matjen, monitorimin, kontrollin, zbutjen dhe raportimin në kohë të rreziqeve ndaj të cilave Banka është ose mund të ekspozohet.

Administrimi i rrezikut mbështetet në:

- strategjinë e biznesit të Bankës
- Kuadrin e Oreksit për Rrezik
- politikat dhe procedurat e miratuara për kategoritë kryesore të rrezikut
- sistemin e limiteve dhe pragjeve të paralajmërimit të hershëm
- ndarjen e qartë të roleve dhe përgjegjësive
- proceset e përshkallëzimit dhe vendimmarrjes
- planifikimin e kapitalit dhe likuiditetit
- analizat e skenarëve dhe testet e rezistencës
- proceset e vazhdimësisë së biznesit dhe rikuperimit nga fatkeqësitë

Kuadri i administrimit të rrezikut përfshin në veçanti rrezikun e kredisë, rrezikun e likuiditetit, rrezikun e tregut, rrezikun e normës së interesit në librin e bankës, rrezikun operacional, rrezikun teknologjik dhe kibernetik, rrezikun e përputhshmërisë dhe rreziqe të tjera materiale.

b) Struktura dhe organizimi i funksionit të administrimit të rrezikut

Administrimi i rrezikut në Jet Bank organizohet sipas modelit të tre linjave të mbrojtjes. Linja e parë: njësitë e biznesit. Linja e dytë: funksioni i administrimit të rrezikut dhe përputhshmërisë. Linja e tretë: Auditimi i Brendshëm.

- Sistemet e raportimit dhe matjes së rrezikut
- Politikat e zbutjes së rrezikut dhe monitorimi i efikasitetit

6.1.
RREZIKU I KREDISË - INFORMACION I PËRGJITHSHËM

a) Përkufizimi i kredive me probleme

Banka konsideron kredi me probleme ekspozimet e klasifikuara në kategoritë "nënstandard", "të dyshimta" dhe "të humbura". Në datën e raportimit, Banka nuk kishte kredi të klasifikuara si kredi me probleme, pasi produkti i kredisë nuk ishte lançuar ende.

• Metoda e krijimit të fondeve rezervë për humbjet nga kreditë
Banka ka përcaktuar kuadrin për klasifikimin dhe krijimin e fondeve rezervë. Në datën e raportimit, Banka nuk kishte krijuar fonde rezervë pasi nuk kishte portofol aktiv kredie.
• Politika e administrimit të rrezikut të kredisë

Në datën e raportimit, Banka nuk kishte portofol kredie ndaj klientëve. Për këtë arsye, të gjithë treguesit sasiorë janë me vlerë zero.

6.2.
RREZIKU I KREDISË - PORTOFOLI SIPAS METODËS STANDARDE

Ekspozimet kryesore klasifikoheshin në: ekspozime ndaj qeverive qendrore dhe bankave qendrore, ekspozime ndaj institucioneve financiare, ekspozime ndaj korporatave. Banka nuk ka përdorur vlerësime të institucioneve të jashtme (ECAI).

KLASA E EKSPOZIMIT	KUNDËRPARTITË KRYESORE	EKSPOZIMI PARA ZBUTJES (MIJË LEKË)	EKSPOZIMI PAS ZBUTJES (MIJË LEKË)
Qeveri qendrore dhe bankë qendrore	Banka e Shqipërisë - llogari dhe depozita	1,459,596	**1,459,596**
Institucione financiare	Banking Circle S.A., ProCredit Bank AG,Aktif Bank	495,133	**495,133**
Korporata / ekspozime të tjera	Jet Tech	220,920	**220,920**
Reatil/Individët	Individët	199,652	**199,652**
TOTALI		**2,375,301**	**2,375,301**

6.3.
TEKNIKAT E ZBUTJES SË RREZIKUT TË KREDISË

Në datën e raportimit, Jet Bank nuk kishte portofol kredie ndaj klientëve dhe nuk kishte ekspozime të mbuluara me kolateral, garanci, kundërgaranci apo forma të tjera të mbrojtjes së kredisë.

• Vlera e ekspozimit neto i mbuluar nga kolaterali financiar/netimi/marrëveshjet/mbrojtje të tjera
• Vlera e ekspozimit neto i mbuluar nga garanci, kundërgaranci, derivativë krediti

6.4.
RREZIKU I KREDISË SË KUNDËRPARTISË

Jet Bank administron rrezikun e kredisë së kundërpartisë nëpërmjet vlerësimit të cilësisë së kundërpartive, përcaktimit të limiteve të ekspozimit, monitorimit të vazhdueshëm të pozicioneve dhe kontrollit të përqendrimeve.
Në datën e raportimit, Banka nuk kishte kolateral apo garanci të njohura për qëllime prudenciale në lidhje me rrezikun e kredisë së kundërpartisë.

6.5.
RREZIQET E TREGUT - INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Përmbledhje cilësore mbi rreziqet e tregut sipas kërkesave rregullative

Jet Bank administron rreziqet e tregut në përputhje me kërkesat e Bankës së Shqipërisë dhe me politikat e brendshme të miratuara. Rreziku i tregut përfaqëson mundësinë e humbjeve që mund të lindin nga ndryshimet e pafavorshme në normat e interesit, kurset e këmbimit, çmimet e instrumenteve financiare dhe faktorë të tjerë të tregut.
Në datën e raportimit, ekspozimi i Bankës ndaj rrezikut të tregut lidhej kryesisht me luhatjet e kursit të këmbimit. Banka nuk kishte ekspozime materiale ndaj instrumenteve të kapitalit.

6.6.
RREZIKU OPERACIONAL

Metoda e përdorur (Treguesi i Thjeshtë ose Metoda Standarde)

Rreziku operacional është rreziku i humbjes që rezulton nga procese të brendshme të papërshtatshme ose të dështuara, gabime njerëzore, sisteme të papërshtatshme ose të dështuara, veprimtaria e ofruesve të jashtëm apo ngjarje të jashtme.
Duke qenë një bankë digjitale, Jet Bank i kushton rëndësi të veçantë qëndrueshmërisë operacionale, sigurisë së informacionit dhe sigurisë kibernetike, menaxhimit të palëve të treta, administrimit të incidenteve dhe vazhdimësisë së biznesit.
Kuadri i administrimit të rrezikut operacional përfshin:

- identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve operacionale në procese, produkte, sisteme dhe aktivitete të reja
- regjistrimin, analizimin dhe ndjekjen e incidenteve dhe humbjeve operacionale
- monitorimin e treguesve kryesorë të rrezikut operacional
- vlerësimin dhe testimin e kontrolleve të brendshme
- kontrollet mbi ndryshimet në sisteme, akseset, ndarjen e detyrave dhe sigurinë kibernetike
- administrimin e rrezikut që lidhet me ofruesit e jashtëm dhe shërbimet e deleguara
- planet e vazhdimësisë së biznesit dhe rikuperimit nga ndërprerjet
- raportimin dhe përshkallëzimin e incidenteve dhe tejkalimeve materiale pranë strukturave drejtuese

Për llogaritjen e kërkesës për kapital dhe të aktiveve të ponderuara për rrezikun operacional, Banka përdor Metodën Standarde.

6.7.
RREZIKU I NORMËS SË INTERESIT NË LIBRIN E BANKËS

Rreziku i normës së interesit në librin e bankës lind kryesisht nga mospërputhjet ndërmjet maturiteteve dhe periudhave të riçmimit të aktiveve dhe pasiveve, ndryshimet ndërmjet normave të ndryshme të referencës, ndryshimet në kurbën e normave të interesit dhe sjellja e klientëve ndaj produkteve bankare.
Banka e mat këtë rrezik nëpërmjet analizës së hendekut të maturimit dhe riçmimit, ndjeshmërisë së të ardhurave neto nga interesi dhe vlerës ekonomike të kapitalit, si dhe testeve të stresit.
Në datën e raportimit, Banka nuk kishte portofol aktiv kredie ndaj klientëve, ndaj supozimet për parapagimin e kredive nuk kishin ndikim material.

IRRBB	Monedha	Shuma
POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHËS - (FIR+VIR) - monedha LEK	LEK	14,153
POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHËS - (FIR+VIR) - monedha EUR	EUR	(23,323)
POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHËS - (FIR+VIR) - monedha USD	USD	--
POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHËS - (FIR+VIR) - monedha të tjera	TE TJERA	--
NDRYSHIMI NË VLERËN E EKSPOZIMIT		9,170
KAPITALI RREGULLATOR (own funds)	**--**	**1,228,889**
(NDRYSHIMI NË VLERËN E EKSPOZIMIT / KAPITALI RREGULLATOR) * 100		**1**

6.8.
RREZIKU I LIKUIDITETIT

Përmbledhje sipas rregullores ‘Për administrimin e rrezikut të likuiditetit’

Banka administron rrezikun e likuiditetit në përputhje me kërkesat e Bankës së Shqipërisë dhe politikat e brendshme të miratuara. Kuadri i administrimit përfshin identifikimin, matjen, monitorimin dhe raportimin e rrezikut të likuiditetit, në kushte normale dhe në skenarë stresi. Banka monitoron flukset hyrëse dhe dalëse, hendekun e maturiteteve, nivelin e aktiveve likuide, përqendrimin e burimeve të financimit dhe treguesit rregullatorë të likuiditetit.
Funksioni i thesarit administron pozicionin e përditshëm të likuiditetit brenda limiteve të miratuara, ndërsa funksioni i Riskut kryen monitorim të pavarur dhe raporton pranë strukturave drejtuese.
Banka kryen teste periodike stresi, monitoron treguesit e paralajmërimit të hershëm dhe mban një Plan Kontigjence të Likuiditetit për menaxhimin e situatave të mundshme të stresit.

7.

EKSPOZIMET NË INSTRUMENTE KAPITALI

Qëllimi i investimeve

Investimet në instrumente kapitali në librin e bankës kryhen vetëm brenda strategjisë së miratuar të investimeve, oreksit për rrezik dhe limiteve të brendshme. Sipas natyrës së tyre, ato mund të synojnë gjenerimin e të ardhurave dhe fitimeve kapitale në një horizont afatmesëm ose afatgjatë, mbështetjen e marrëdhënieve të biznesit ose objektiva strategjikë. Investimet nuk ndërmerren për tregtim afatshkurtër.

Politikat kontabël, teknikat dhe metodat e vlerësimit

Instrumentet e kapitalit njihen, klasifikohen dhe maten në përputhje me kuadrin e raportimit financiar të zbatueshëm nga Banka. Në njohjen fillestare, instrumentet maten me vlerën e drejtë. Pas njohjes fillestare, vlera e drejtë përcaktohet sipas radhës, duke përdorur çmime të kuotuara në tregje aktive, të dhëna të vëzhgueshme të tregut ose teknika vlerësimi të pranuara.

EKSPOZIMET SIPAS INSTRUMENTIT DHE MËNYRËS SË TREGTIMIT

INSTRUMENTI / EMETUESI	LLOJI I EKSPOZIMIT	VLERA KONTABËL	VLERA E DREJTË	ÇMIMI I TREGUT/ BURIMI	DIFERENCA
AL000A4EXPZ0	**HTM**	**200,098**	**197,841**	**98.92%**	-2,257
AL000A4EXPZ0	**HTM**	**99,996**	**98,920**	**0.9892**	**-1,076**
AL000A4EXP20	**HTM**	**96,172**	**96,415**	**96.42%**	244
Totali		**396,266**	**393,177**		**-3,089**

FITIMET DHE HUMBJET NGA INSTRUMENTET E KAPITALIT

KATEGORIA	FITIME/(HUMBJE) KUMULATIVE TË REALIZUARA	FITIME/(HUMBJE) TË PAREALIZUARA	PJESA E PËRFSHIRË NË KAPITAL
Të tregtueshme në bursë	0	0	0
Ofertë private	0	0	0
Të tjera	0	0	0
Totali	**0**	**0**	**0**

8.

KREDITË SIPAS AFATIT TE MBETUR TË MATURIMIT DHE KRIJIMI I FONDEVE REZERVË

KREDITË SIPAS MATURIMIT TË MBETUR	1 ditë	2-7 ditë	8-15 ditë	16-30 ditë	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vite	>5 vite	Totali
Hua Standarde	939					1,119	5,397	90,334	101,863	199,652
Hua në ndekje	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Hua nën-standarde	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
Hua të dyshimta	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Hua të humbura	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-

Fondet rezervë të krijuara nga banka

INSTRUMENTI / EMETUESI	Teprica në fillim	Shtimi i provigjion-eve	Rimarrje e provigjioneve	Kreditë e fshira gjatë periudhës	Korigjime të tjera gjatë periudhës	Teprica në fund
FR për zhvlerësimin e bonove të përshtatshme për rifinancim me Bankën Qendrore	0	0	0	0	0	0
FR për llogaritë për t'u arkëtuar nga bankat, inst.e kredi-tit e inst.tjera fin me status të dyshimtë	0	0	0	0	0	0
FR për mbulimin e humbjeve nga huatë nënstandarde	0	0	0	0	0	0
FR për mbulimin e humbjeve nga huatë e dyshimta	0	0	0	0	0	0
FR për mbulimin e humbjeve nga huatë e humbura	0	0	0	0	0	0
FR mbulimin e humbjeve nga llogaritë për t'u arkëtuar prej Qeverisë Shqiptare e org tjera publike me status të dyshimtë	0	0	0	0	0	0
FR për llogaritë për t'u arkëtuar të klientëve në status të dyshimtë përveç huave	0	0	0	0	0	0
FR për të mbuluar zhvlerësimin	0	0	0	0	0	0
FR për të mbuluar zhvlerësimin	0	0	0	0	0	0
FR për zhvlerësimin e mjeteve të tjera	0	0	0	0	0	0
FR për zhvlerësimin	0	0	0	0	0	0
FR për zhvlerësimin	0	0	0	0	0	0
FR për amortizimin e mjeteve të qëndrueshme	0	0	0	0	0	0
FR për rreziqe e shpenzime	0	1,996,519	0	0	0	1,996,519
FR specifike të tjera	0	0	0	0	0	0
TOTALI	0	1,996,519	0	0	0	1,996,519

Fondet rezervë të krijuara nga banka

Klasifikimi i kredive	Kryegjëja	Norma për provigjone	Fonde rezervë për kryegjënë	Interesat e perlloga-ritur	Norma për provigjone	F.R. për interesat
Kredi standarde dhe kredi e pakthyer në afat	198,713	0.01	1,987	939	0.01	9
Kredi standarde të ristrukturuara	0	0.1	0	0	0.1	0
Kredi në ndjekje	0	0.05	0	0	0.05	0
Kredi në ndjekje të ristrukturuara	0	0.1	0	0	0.1	0
Kredi nënstandarde	0	0.2	0	0	1	0
Kredi të dyshimta	0	0.5	0	0	1	0
Kredi të humbura	0	1	0	0	1	0
TOTALI	198,713		1,987	939		9

9.
RREZIKU I LIKUIDITETIT

Kuadri i administrimit të likuiditetit

Banka administron rrezikun e likuiditetit me synim përmbushjen në kohë të të gjitha detyrimeve të pagesës, ruajtjen e kërkesave rregullatore dhe të limiteve të brendshme, si dhe përdorimin eficient të fondeve. Departamenti i Thesarit administron pozicionin ditor të likuiditetit dhe strukturën e financimit, ndërsa funksioni i administrimit të rrezikut kryen monitorim të pavarur kundrejt limiteve dhe treguesve të paralajmërimit të hershëm.
Burimet kryesore të likuiditetit përfshijnë kapitalin, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat e klientëve, fondet nga institucionet financiare dhe flukset nga maturimi i aktiveve. Banka ruan rezerva likuiditeti dhe burime alternative financimi në përputhje me profilin e saj të rrezikut dhe planin e emergjencës së likuiditetit.

AKTIVET LIKUIDE DHE POZICIONI I FONDEVE

AKTIVE LIKUIDE - PASIVE AFATSHKURTRA	ALL	USD	EUR	TË TJERA	TOTALI
a. Arka	-	-	-	-	-
b. Llogaritë me Bankën e Shqipërisë, duke përfshirë rezervën e detyruar deri ne masën e përdorimit të saj	**1,294,014**	-	**96,032**	-	**1,390,046**
c. Bonot e thesarit të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, të regjistruara në bilanc si "të tregtueshme"/"të vendosjes", të cilat nuk janë përdorur si garanci në një marrëveshje riblerjeje	-	-	-	-	-
d. 80 për qind të obligacioneve të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë të regjistruara në bilanc si "të tregtueshme"/"të vendosjes", të cilat nuk janë përdorur si garanci në një marrëveshje riblerjeje	-	-	-	-	-
e. Letra me vlerë "të investimit" të Qeverisë Shqiptare (bono thesari dhe obligacione) me maturim të mbetur deri në 1 (një) muaj	-	-	-	-	-
f. 80 për qind të letrave me vlerë të qeverisë shqiptare (bono thesari dhe obligacione), që nuk bëjnë pjesë në kodin "3", "4" dhe "5", por që plotësojnë kriteret e rregulloreve të Bankës së SHqipërisë "Mbi garancitë në operacionet kredituese të Bankës së Shqipërisë" dhe 'Mbi marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes"	**320,000**	-	-	-	**320,000**
g. Bonot e thesarit të blera sipas marrëveshjeve të riblerjes, kur maturimi i mbetur i marrëveshjes së riblerjes është deri në 7 (shtatë) ditë	-	-	-	-	-
h. Llogaritë rrjedhëse në bankat dhe institucionet e tjera financiare	-	-	**255,891**	-	**255,891**
i. Depozita me bankat dhe institucionet e tjera financiare me maturim të mbetur deri në 7 (shtatë) ditë	-	-	**239,330**	-	**239,330**
j. Hua për bankat dhe institucionet e tjera financiare me maturim të mbetur deri në shtatë ditë (përjashtohet llogaria 157 "hua të paktheyra në afat ndaj bankave dhe institucioneve të tjera financiare");	-	-	-	-	-
k. Letrat me vlerë "të tregtueshme"/"të vendosjes" të emetuara nga qeveritë qendrore dhe bankat qendrore me klasifikime nga agjencitë ndërkombëtare të rating-ut ekuivalente me klasifikimin e S&P jo më pak se A +;	-	-	-	-	-
l. Letra me vlerë "të tregtueshme"/"të vendosjes" të emetuara nga institucione financiare me vlerësim nga agjencitë ndërkombëtare të rating-ut ekuivalente me klasifikimin e S&P jo më pak se A+;	-	-	-	-	-
m. Letra me vlerë "të tregtueshme"/"të vendosjes" që nuk janë të vlerësuara, por të emetuara nga banka ndërkombëtare të zhvillimit të listuara në rregulloren e Bankës së Shqipërisë "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave";	-	-	-	-	-
n. Letra me vlerë "të investimit" me maturim të mbetur deri në 1 (një) muaj (duke perjashtuar letrat me vlerë të Qeverisë Shqiptare të përfshira në shkronjat e mësipërme)	-	-	-	-	-
o. Letra me vlerë të blera sipas marrëveshjes së riblerjes, kur maturimi i mbetur i marrëveshjes së riblerjes është deri në 7 (shtatë) ditë	-	-	-	-	-
TOTALI i aktiveve likuide	**1,614,014**	-	**591,253**	-	**2,205,267**
TOTALI i pasiveve afatshkurtra me afat te mbetur maturimi deri ne 1 vit	**448,810**	-	**689,099**	-	**1,137,909**

AKTIVET DHE PASIVET AFATSHKURTRA SIPAS MATURITETIT TË MBETUR
BURIMET E FONDEVE NGA TË TRETËT SIPAS MATURITETIT

AKTIVET SIPAS MATURIMIT TË MBETUR	1 ditë	2-7 ditë	8-15 ditë	16-30 ditë	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vite	>5 vite	TOTALI
TREGUESI (NË MIJË LEKË)	2,319,633	239,330	0.00	0.00	0.00	1,119	5,397	489,460	101,863	3,156,802
TOTALI I AKTIVIT + TOTALI I ZERAVE JASHTË BILANCIT	**2,319,633**	**239,330**	**0.00**	**0.00**	**0.00**	**1,119**	**5,397**	**489,460**	**101,863**	**3,156,802**

PASIVET SIPAS MATURIMIT TË MBETUR	1 ditë	2-7 ditë	8-15 ditë	16-30 ditë	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vite	>5 vite	TOTALI
TREGUESI (NË MIJË LEKË)	2,170,318	550	0.00	0.00	3,143	5,461	531,569	381,749	0	3,092,788
TOTALI I PASIVIT + TOTALI I ZERAVE JASHTË BILANCIT	**2,170,318**	**550**	**0.00**	**0.00**	**3,143**	**5,461**	**531,569**	**381,749**	**0**	**3,092,788**

AKTIVET E TITULLZUARA DHE AKTIVET ME KUFIZIME

KATEGORIA	VLERA KONTABËL	VLERA E DREJTË	QËLLIMI / PËRFITUESI	AFATI I KUFIZIMIT
Aktive të titullzuara	0	0	Nuk ka	Nuk zbatohet
Aktive të vendosura si kolateral ose me kufizime të tjera	0	0	Nuk ka	Nuk zbatohet
TOTALI	**0**	**0**		


Jet.bank